



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Malishevës
Opstina / Municipality of Malishevë
Drejtoria për Urbanizëm

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

11/09/2024

05/171

Data: 08.04.2024

Numri i vrojtimit i Lejes: 05/140

Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Malishevës në bazë të nenit 14,15,18,19,20 dhe 21 të Ligjit të Ndërtimit, nr. 04/L-110 dhe Ligjit për Planifikim Hapësinor me Nr. 04/L-174 të datës: 31.07.2013, nenit,1,2 pika 1,1 dhe 1.2 nenit 21,22 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 të datës: 21.06.2016, Neni 17, pika “d” të ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, të datës. 20.02.2008, Udhëzimit Administrativ mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor me nr. 08/2017 të datës: 09.06.2017, Udhëzimit Administrativ për kategorizimin e ndërtimeve me nr. 04/2017, nenit 14,16,17,21,22 të Udhëzimit Administrativ për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për Kushte ndërtimore, Leje ndërtimore dhe Leje rrënimi për kategorinë I dhe të II-të të ndërtimeve me nr. 06/2017 të datës: 23.05.2017, Rregullores Nr. 03/2016 për Normat Minimale Teknike për Ndërtesat e banimit në Bashkëpronësi të datës: 04.11.2016, dhe Planit Zhvillimor Komunal 2019-2027 të Komunës së Malishevës duke vendosur sipas kërkesës nr. 05/140 të datës: 21.03.2024 të aplikuesit Sadrush Krasniqi me seli në Malishevë, për lejimin e ndërtimit të objektit banim individual – shtëpi private me etazhitet P+1, ZK Malishevë, Drejtoria për Urbanizëm në procedurë të rregullt administrative pas shqyrtimit të lëndës lëshon këtë:

VENDIM PËR LEJE NDËRTIMORE

I.

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	SADRUSH KRASNIQI		
Adresa:	Rr. “Ushtria Kosovës” në Malishevë		
Telefoni:	+383 49 844 356	Emaili:	

II.

Emri i Projektit:	SHTËPI INDIVIDUALE; P+1		
Emri i Projektuesit:	Studio Projektuese: BA Ing Projekt SH.P.K		
Adresa:	Rruga “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” pn, Malishevë, Kosovë		
Telefoni:	+383 49 440 278	Emaili:	



III.

Për punët ndërtimore në vijim:		
Adresa: Rruga "Ushtria Kosovës" në Malishevë		
Zona(t) Kadastrale: Malishevë	Nr. I parcelës kadastrale: 1004-686	GPS Koordinatat:
Lloji i ndërtimit të propozuar:		
Ndërtimi i ri: <input checked="" type="checkbox"/>	Rindërtim: <input type="checkbox"/>	Riparim: <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:		
Kategoria I: <input checked="" type="checkbox"/>	Kategoria II: <input type="checkbox"/>	
Përdorimi i propozuar: Banim individual	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po: <input type="checkbox"/> Jo: <input checked="" type="checkbox"/>	
Përshkrimi:		
Objekti banim individual – shtëpi private me etazhitet P+1		
Bazuar në dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, të prezantuar dhe miratuar nga kjo drejtori, sipërfaqja e tërësishme bruto ndërtimore e objektit të banimit individual me etazhitet P+1: Sipërfaqja mbitokësore e tërësishme e lejuar për ndërtim është S=213.46 m , me nivele ndërtimore dhe me kuota të nivelit të dyshemesë së përdhesës, si dhe lartësi deri në dyshemenë e katit të fundit dhe kulmit, për objektin si në vijim: Shtëpi individuale me 2 nivele ndërtimore, me kuota relative të nivelit të dyshemesë së përdhesës +0.00 m, dyshemesë së katit 1 +3.20_m, dhe katit të fundit + 7.10_m, dhe Destinimi, nivelet me kuota relative, përmbajtja dhe sipërfaqet e ndërtesave, janë:		
Përdhesa (0.00 m) me sipërfaqe prej 106.11 m² , me destinim dhe përmbajtje: hapësira komunikuese (shkallë dhe koridore) dhe hapësira banimi.		
Kati 1 (+3.20 m) me sipërfaqe prej 107.35 m² ; me destinim dhe përmbajtje: hapësira komunikuese (shkallë dhe koridore) dhe hapësira banimi.		

IV. Me këtë leje ndërtimore lejohej vendosja/ndërtimi i ndërtesave ndihmëse/montazhe, të planifikuara sipas elaboratit për organizimin e vendndërtimit, për nevoja të kompanisë ekzekutuese dhe mbikëqyrës të ndërtimit, në afatin kohor deri në momentin e realizimit të ndërtimit.

V. Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Të vendos tabelën informuese në vend ndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informata mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vend ndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit;

- dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
- librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
- protokollin e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
- Të dorëzoj njoftim inspektoriatit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftoj organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

Arsyetim

Aplikuesit/pronarët Sadrush Krasniqi me seli në Malishevë, me kërkesën nr.05/140 të datës: 21.03.2024 ka kërkuar nga Drejtoria për Urbanizëm lëshimin e Lejes Ndërtimore për objektin: shtëpi individuale me etazhitet P+1, kategoria I e ndërtimit, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të këtij vendimi.

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore Sadrush krasniqi me seli në Malishevë i lejohet ndërtimi i Objektit banim individuale me etazhitet P+1 kategoria I e ndërtimit, në ngastrën kadastrale Nr. **P-72310047-01004-686**, Zona Kadastrale Malishevë me sipërfaqe totale prej **450 m²** e drejta pronësore juridike (në pronësi të bashkëpronarëve: Sadrush Krasniqi dhe Zejnije Krasniqi) në bazë të Certifikatës së Pronësisë 45433/23 të datës: 27.09.2023 dhe Kopjes të Planit të datës: 11.09.2023.

Drejtoria e Urbanizmit, duke u bazuar në përmbajtjen e dokumentacionit në dosjen e kërkesës/lëndës me nr. 05/140 të datës: 21.03.2024, konstatoi se është prezantuar dhe trajtuar dokumentacioni i mëposhtëm:

- Shtojca Nr.2 Kërkesë për Leje Ndërtimore për Kategorinë e I-rë.
- Akti administrativ “Vendim për caktimin e Kushteve Ndërtimore” me nr.05/113 të datës 11.03.2024 të lëshuara nga kjo Drejtori se bashku me protokollin e rregullimit;
- Parcela kadastrale me Nr. P-72310047-01004-686, Zona Kadastrale Malishevë me sipërfaqe totale prej 450 m² e drejta pronësore juridike (në pronësi të bashkëpronarëve: Sadrush Krasniqi dhe Zejnije Krasniqi) në bazë të Certifikatës së Pronësisë 45433/23 të datës: 27.09.2023 dhe Kopjes të Planit të datës: 11.09.2023.

- Pagesa e taksës administrative për leje të ndërtimit dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, e llogaritur sipas akti administrativ “Aktvendim për caktimin e taksës administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës”, me Nr.3024000174 të datës: 05.04.2024, në shumën prej 1004.00 €, paguar në “Vllesa-co” me datë: 05.04.2024.
- Pëlqimi nga Kompania Regjionale për Mbeturina “Eco Regjioni” sh.a të datës: 21/03/2024
- Pëlqim Elektroenergjetik nga KEDS Nr.4/160 datës: 28.03.2024
- Vërtetim nga K.R.U “ HIDROREGJIONI JUGOR” Sh.a të datës: 21.03.2024
- Kopja e letërnjoftimit të palës.
- Tri kopje të dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor të ndërtesës së planifikuar, në kopje të fortë/fizike dhe një kopje digjitale CD, të hartuar nga kompania projektuese “BA Ing Projekt” SH.P.K me seli në Malishevë, me certifikat të regjistrimit të biznesit nr.811908089
- Arkitektura “BA Ing Projekt”
- Struktura “BA Ing Projekt”
- Hidroinstalimet “BA Ing Projekt”
- ElektriKa “BA Ing Projekt”
- Makineria “BA Ing Projekt”

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr.02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitave tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për **lëshimin e Lejes Ndërtimore**, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vërejte: Çdo ndryshim i projektit nga kushtët e aprovuara nga drejtoria e Urbanizmit është përgjegjësi e investitorit dhe kompanisë projektuese.

Nga një kopje të vendimit t’i dërgohet:

- 1.Parashtruesit të kërkesës
- 2.Inspeksionit
- 3.Kësaj Drejtorie

Punoi:


Msc.ark. Lulzim Mazreku

DREJTOR / DREJTORISË


Avdi Morina